



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1852/1 prot.

Puke, me 05.10.2024

Njoftim për këshillim me publikun për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2025-2027

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit Nr. 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në nenin 9 pika 1.3, nenin 34, të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar nenin 34 të ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 03 datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" dhe shtojcat plotësuese dhe udhëzimit plotësues Nr. 08 datë 05.07.2024 për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027" të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Bashkia Pukë bën public kalendarin e konsultimit publik të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027.

Propozuesit : Komisioni i Ekonomiko-financiar **dhe Drejtoria e menaxhimit financiar.**

Sqarime për projekt-aktin: Stafi i Bashkisë do të informojë komunitetin mbi të dhënat e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe buxhetit të bashkisë për vitin 2025 për secilin prej programeve buxhetore.

Qëllimi i këtij konsultimi është të mblidhen sugjerimet e komunitetit lidhur me:

- **Mënyrën se si do të shpenzohen fondet për ofrimin e shërbimeve nga Bashkia.**
- **Shërbimet prioritare të komunitetit.**

Grupet që do të konsultohen: Banorët e Bashkisë, përfaqësues nga shoqëria civile, përfaqësues të biznesit, medias dhe akademisë, Kryetarët e Fshatrave.

Të dhenat në lidhje me Programin Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe buxhetit të bashkisë për vitin 2024 për secilin prej programeve buxhetore janë të publikuara në faqen web të keshillit dhe të Bashkisë Puke. Gjate takimeve do të japim informacione mbi investimet dhe shërbimet kryesore që ofron Bashkia dhe mbi procesin që do të ndiqet për trajtimin e rekomandimeve.

Kalendari – për keshillim me publikun


Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Menyra	Forma
1	Konsultim publik me banorët e Njesise administrative Gjegjan	24.10.2024	Njesia administrative Gjegjan	13:00	Takim publik	Bisedë
2	Konsultim publik me banorët e Njesise administrative Qerret	29.10.2024	Njesia administrative Qerret	11:00	Takim publik	Bisedë
3	Konsultim publik me banorët e Njesise administrative Qelez	31.10.2024	Njesia administrative Qelez	11:00	Takim publik	Bisedë
4	Konsultim publik me banorët e Njesive administrative Rrape	05.11.2024	Njesia administrative Rrape	11:00	Takim publik	Bisedë
6	Konsultim publik me banorët e Njesise administrative Puke	08.11.2024	Salla mbledhjeve të Këshillit Bashkiak	13:00	Takim publik	Bisedë

Ftojme të gjithë të qytetarët e bashkisë të behen pjesë e hartimit të buxhetit duke u konsultuar me dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe buxhetit të bashkisë për vitin 2025 për secilin programeve buxhetore të publikuara në faqen web të keshillit dhe të Bashkisë Puke. Jepni mendimin tuaj tek adresa

keshilibashkiakupuke@gmail.com Bashkiakupuke@yahoo.com deri me 25 Nentor 2024.

Sekretari i Keshillit

Hazbi Terbuni



Adresa: Bashkia Puke, sheshi "Gjergj Kastrioti Skenderbeu" e-mail: bashkiakupuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiakupuke.gov.al